

KLUBI I VAJZAVE

Nismëtare të lidershipit të vajzave



Një vajzë lidere beson në aftësitë personale për të sjellë ndryshimin në botë, është e angazhuar tek të mësuarit aktiv, si dhe vepron në mënyrë individuale dhe me të tjerët për të sjellë ndryshime pozitive!

Si mund të nxiten vajzat që të zhvillojnë lidershipin në moshë të vogël?

- Aksesi ndaj edukimit të barabartë
- Hartimi i politikave me ndjeshmëri gjinore
- Promovimi i modeleve pozitive
- Nxitja e pjesëmarrjes së vajzave në shoqëri
- Adresimi i praktikave të dëmshme tradicionale
- Krijimi i hapësirave të sigurta



NXITJA DHE ORIENTIMI I VAJZAVE DREJT LIDERSHIPIT

- sfidon premisën mbizotëruese se vetëm djemtë e burrat mund të drejtojnë
- sjell përfitime për të gjithë shoqërinë, në aspektin social, ekonomik, politik apo kulturor

Bota ka nevojë për vajzat dhe gratë e forta!



Ne kemi nevojë që të kemi një konceptim të ri mbi lidershipin dhe fuqinë. Bota ka nevojë për vajza dhe gra që imagjinojnë, kanë një vizion të qartë dhe bashkëudhëheqin drejt një kulture të re... një kulture ku barazia vlen më shumë se dominanca... kulturën që ka në thelb shpirtin...